



Pranuar / Dorezuar Prijeno / Prodato Received / Delivery	18. 12 2023	3	viti god year
Organ / Njesia Org. / Jedinica Org. / Unit	SKANSKA	7525 / 2023	113
Nr Prot Br Prot Prot No		Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1389/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-Kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.1389/2023 të datës 07.11.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë rr. [redacted] Vushtrisë, kundër organit të punësimit Komuna e Vushtrisë, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 18.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pasafatshme ankesa me numër A.nr.1389/2023 e datës 07.11.2023 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

Ankuesja [redacted] më datë 07.11.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokollit 6922/2023, me pretendimin ankimor që ti bëhet kompensimi sipas vendimit me numër 654/18 të datës 15.05.2018 për pozitën "Zyrtar Certifikues" në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa si dhe kompensimin sipas autorizimit me numër 1489/22 të datës 24.11.2022 të Kryetarit të Komunës së Vushtrisë për pozitën "Zyrtar Shpenzues" në kuadër të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa të Komunës së Vushtrisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.11.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Vushtrisë, ndërsa Këshilli më datë 20.11.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Vushtrisë, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 6922/2023 të datës 07.11.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim me numër protokollit 579/22 i datës 05.05.2022 i Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë; Autorizim me numër protokollit 1489/22 i datës 24.11.2022 i Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë; E-mail nga B.D. për M.R. i datës 05.12.2022; E-mail nga M.R. për B.D. i datës 05.12.2022; Vendim me numër protokollit 654/18 i datës 15.05.2018 i Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë; Vendim me numër protokollit 15/19 i datës 09.01.2019 i Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë; Vendim me numër protokollit 1009/19 i datës 19.08.2019 i Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë; Vendim me numër protokollit 367/20 i datës 29.04.2020 i Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë; Vendim me numër protokollit 455/21 i datës 16.04.2021 i Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë; Autorizim me numër protokollit 1454/21 i datës 16.12.2021 i Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë; E-mail nga M.R. për ankesa.kpmschck@rks-gov.net i datës 07.11.2023; E-mail nga ankesa.kpmschck@rks-gov.net për M.R. i datës 07.11.2023; E-mail nga M.R. për ankesa.kpmschck@rks-gov.net i datës 07.11.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 16.11.2023; Përgjigje në ankesë e datës 20.11.2023; Vendim me numër protokollit 24003/23 i datës 01.06.2023 i Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Vushtrrisë; E-mail nga M.R. për B.D. i datës 31.05.2023; Njoftim për shpëputje të marrëdhënies së punës nga M.M. i datës 15.05.2023; Akt Emërim i M.R. me nr. 718 i datës 25.01.2011; Kontratë Pune e M.R. i datës 29.01.2010; Përshkrimi i vendit të punës për pozitën Zyrtar për zotime; Përshkrimi i vendit të punës për pozitën Zyrtar për zotime me 04 nr./07 i datës 02.07.2007; Lista e pagave e muajit Janar 2019; Vendim me numër protokollit 486/19 i datës 10.04.2019 i Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë; Lista e pagave e muajit Prill 2019; Lista e pagave e muajit Gusht 2019; Vendim me numër protokollit 850/20 i datës 08.10.2020 i Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë; Lista e pagave e muajit Gusht dhe Tetor 2020; Vendim me numër protokollit 1384/21 i datës 01.12.2021 i Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë; Lista e pagave e muajit Dhjetor 2021; Lista e pagave e muajit Maj, Qershor dhe Korrik 2020;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses, **është e palejuar, sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës konkretisht sipas Vendimit të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Vushtrrisë me numër protokollit 24003/23 të datës 01.06.2023, Nëpunësja Merita Mulaku, në vendin e punës ‘*Zyrtare për Buxhet dhe Financa*’ në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa ka dhënë dorëheqje nga vendi i punës për shkak se është punësuar në Ministrinë e Arsimit, përmes Lëvizjes Brenda Kategorisë, andaj sipas Ligjit për Zyrtarët Publik i përfundon punësimi.

Ankuesja, me datë 07.11.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që ti bëhet kompensimi sipas vendimit me numër 654/18 të datës 15.05.2018 për pozitën ‘*Zyrtar Certifikues*’ në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa si dhe kompensimin sipas autorizimit me numër 1489/22 të datës 24.11.2022 të Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë për pozitën ‘*Zyrtar Shpenzues*’ në kuadër të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa të Komunës së Vushtrrisë.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankueses, konstaton se sipas nenit 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është përcaktuar se: *“Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: “heshtja administrative”)*”, si rrjedhojë ankuesja ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar lidhur me kompensimin sipas vendimit me numër 654/18 të datës 15.05.2018 për pozitën ‘*Zyrtar Certifikues*’ në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa si dhe



kompensimin sipas autorizimit me numër 1489/22 të datës 24.11.2022 të Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë për pozitën ‘Zyrtar Shpenzues’ në kuadër të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa të Komunës së Vushtrrisë.

Duke marr parasysh afatin për parashtrimin e ankesës ndaj aktit administrativ, Kolegji i Këshillit, ju referua nenit 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili shprehimisht përcakton: “Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data kur është njoftuar për aktin administrativ”, si rrjedhojë meqenëse ankuesja me datë 24.11.2022 me numër 1489/22 ka pranuar Autorizimin të Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë për pozitën ‘Zyrtar Shpenzues’ në kuadër të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa të Komunës së Vushtrrisë, ndërsa ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar më datë 07.11.2023, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, konstaton se ankesa e ankueses e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është parashtruar në kundërshtim me afatin e përcaktuar si më lartë, nga kjo rrjedh se ankesa e ankueses është e pasafatshme dhe si e tillë është e palejuar në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, nisur nga konstatimet si me lartë, Kolegji në mbështetje të nenit 129 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1389/2023

Çlirim Zeka


Procesmbajtës

Eshref Shabani


Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

